Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY
Nr/Br. 297-318/19
Datum. 05.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 297/19
318/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Blerim Dina– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Goran Milenković, - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga operatoret ekonomik:OE "RSM COMPANY" SH.P.K-Prishtinë, me nr. 297/19, (kjo ankese është për Lot III), e parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratë ku është rekomanduar për kontrate OE ''LikaTrade''-Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë", me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës. Si dhe ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik OE: ''Sallahu''SH.P.K-Kaçanik, me nr. 318/19 (e kjo (ankese është parashtruar për LOT I dhe III), kundër njoftimit për dhënie të kontratë ku është rekomanduar për kontrate OE''KagAsphaltCompany''-Prizeren, Për LOT I, ndërsa për Lot III OE: ''LikaTrade''-Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc-Gjakovë'' Lot I - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P1-P180) Stacionazha 0+000.00-4+173.48 dhe Lot III - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P420-P660) Stacionazha 9+274.98-14+253.21, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Infrastrukturës /MI/, më datën 04.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET , kërkesa e operatorit ekonomik " RSM COMPANY" SHP.P.K-Prishtinë, e datës: 03.07.2019, për tërheqje nga ankesa e datës: 10.06.2019, me nr. 297/19, "Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë", me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, (për Lot III), të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Ministria e Infrastrukturës/MI/.

II. HEDHET, si e pa lejuar ankesa e OE "SALLAHU" SH.P.K-Kaçanik (për Lot I dhe III) e datës: 17.06.2019, me nr. 318/19, në pajtim me nenit 4 parg. 26 pika 1 dhe nenin 99 të LPP-së, si dhe nenin 36 të

Rregullores së Punës së OSHP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc-Gjakovë'' Lot I - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P1-P180) Stacionazha 0+000.00-4+173.48 dhe Lot III - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P420-P660) Stacionazha 9+274.98-14+253.21, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Infrastrukturës /MI/.

III.I LEJOHET, autoritetit kontraktues Ministria e Infrastrukturës/MI/, që të vazhdojë më tutje me procrdurat e prokurimit me titull"Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc-Gjakovë'' Lot I - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P1-P180) Stacionazha 0+000.00-4+173.48 dhe Lot III - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P420-P660) Stacionazha 9+274.98-14+253.21, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Infrastrukturës (për Lot I dhe III).

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "SALLAHU" SH.P.K-Kaçanik, hedhet si e pa lejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Meqenëse kërkesa e OE "RSM COMPANY" SH.P.K-Prishtinë, aprovohet, si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 22.04.2019

Data e Hapjes së ofertave është bërë me dt:15.05.2019.

Data e njoftimit mbi vendimin e autoriteti kontraktues është bërë me dt: 03.06.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesit e eliminuar është bërë me dt: 03.06.2019.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 03.06.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim nga OE "RSM COMPANY" SH.P.K-Prishtinë, është bërë me dt: 05.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim nga OE ''Sallahu''-Kaçanik, është bërë me dt: 07.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 05 dhe 10.06.2019

Operatori ekonomik ankues:"RSM COMPANY" SH.P.K-Prishtinë, (për Lot III) me datë:10.06.2019, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc - Gjakovë", me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Ministria e Infrastrukturës /MI/, duke pretenduar në shkelje të dispozitave të LPP-së.

- Shkelje e nenit 1, 59, 60 dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues:OE: ''Sallahu''SH.P.K -Kaçanik, (për Lot I dhe III) me datën 17.06.2019, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1 segmenti Dollc-Gjakovë'' Lot I - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P1-P180) Stacionazha 0+000.00-4+173.48 dhe Lot III - Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë, L=31.00 Profili (P420-P660) Stacionazha 9+274.98-14+253.21, me numër të prokurimit: 205-19-2318-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/-Ministria e Infrastrukturës /MI/,duke pretenduar në shkelje të dispozitave të LPP-së.

- Shkelje e nenit 7, 54, 59, 60, 68 dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së,me datë: 18.06.2019,ka autorizuarekspertin shqyrtues tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 28.06.2019, sqaron pretendimet e OE "RSM COMPANY" SH.P.K-Prishtinë, Në këtë aktivitet te prokurimit ka dorëzuar ofertë vetëm për Lot III, ndërsa pas vlerësimit te ofertave eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

Operatori ekonomik ka ofruar procesverbale te pranimit te punëve ne vlere: 5,992,504.67€, ndërsa kërkesë ne dosjes te tenderit, për Lot III janë kërkuar projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve ne vlerë: 6,000,000.00€.

Nuk ka ofruar dëshmi për finisher për shtrirjen e asfaltit.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyes se pare te eliminimit, lidhur me kontratat dhe referencat, për te cilat AK-MI-ja, ka kërkuar qe për Lot III vlera e kontratave dhe referencave në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve te jetë 6,000,000.00€.

OE ankues ne ofertën e tij e ka dorëzuar listën e kontratave (gjithsej pesë kontrata) ne vlerë totale prej: 7,347,432.75€.

1. Rikonstruimi i rrugës Kukës Shishtavec Lot 3, vlera: 3,043,477.00€.

Lidhur me kontratën e lartpërmendur, AK-ja, gjate vlerësimit ka vërejtur se ne formularin e vlerësimit thuhet se: 60% te punëve i ka përfunduar OE "RSM Company", ndërsa 40% te punëve OE "Eskavatori" dhe duke u bazuar ne përqindjet e dhëna me lart ka rezultuar se OE "RsmCompany", nga totali i ka realizuar vetëm 1,826,086.20€.

Eksperti shqyrtues, sqaron se me rastin e parashtrimit te ankesës ne OSHP, OE ankues, për kontratën e lartpërmendur ka dorëzuar dëshmi shtese se i njëjti e ka përfunduar i vetëm projektin ne fjale.

Dëshmitë e prezantuara lidhur me projektin janë: Akt marrëveshja e datës: 10.04.2014, e OE "RsmCompany" dhe OE "Eskavatori", ku OE "Eskavatori", tërhiqet nga ky projekt dhe deklaron se përgjegjësia për ekzekutimin e projektit bie mbi OE "RsmComapny".

Poashtu lidhur me këtë kontrate si dëshmi shtese OE "RsmComapny" ka ofruar edhe situacionet te cilat i ka dorëzuar tek investitori.

Eksperti shqyrtues, bazuar ne provat e prezantuara me lart, vlerëson se OE ankues këtë kontratë e ka realizuar i vetëm, megjithatë, konform nenit 72 te LPP-se, AK-ja, është dashur te kërkoj sqarime shtese pran autoritetit kontraktues – investitorit i cili e ka nënshkruar këtë kontratë me OE "RsmCompany" për te sqaruar ne mënyrë te detajuar këtë kontratë sepse siç është sqaruar edhe me lart ne raportin e vlerësimit thuhet se: 60% te punëve i ka realizuar OE "RsmCompany" ndërsa 40% te punëve janë kryer nga OE "Eskavatori", ndërsa ne situacionet e dorëzuar te po i njëjti investitor rezulton se punët janë kryer vetëm nga OE "RsmCompany", duke u bazuar këtu edhe ne akt marrëveshjen ku OE "Eskavatori" është tërhequr nga ekzekutimi i projektit.

2. Rikonstruimi i bulevardit Fan Noli dhe ndriçimi i unazës Korc, me vlerë: 1,330,405.80€

Lidhur me këtë kontratë AK-ja, pretendon se kontratat janë kërkuar ne lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve.

Eksperti shqyrtues, poashtu vlerëson se edhe kjo kontratë duhet te sqarohet me detajisht, për vet faktin se titulli: Rikonstruimi i Bulevardit, nuk do te thotë se nuk ka asfalt, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, nuk ka nxjerr një konstatim te saktë lidhur me këtë kontratë.

Ne fund, sa i përket kontratave dhe referencave, eksperti shqyrtues, vlerëson se pa verifikimin dy kontratave te lartpërmendura është e pamundur te konstatohet se a e plotëson kërkesën e AK-se ne vlerë prej: 6,000,000.00€, për faktin se këto dy kontrata e bëjnë dallimin se a e plotëson OE ankues "RsmCompany", kërkesën për kontrata dhe referenca.

Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit, lidhur me finisherin, eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues konform kërkesës se dosjes se tenderit ka ofruar dëshmi se e ka ne posedim Finsherin. Pra, për te njëjtën pajisje OE ankues ka dorëzuar marrëveshjen me OE "Rruga Ing" dhe faturën si dëshmi se e ka ne posedim, qe do te thotë se kjo arsye e eliminimit te OE ankues nuk qëndron.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne letrën standarde te tenderuesit te eliminuar është edhe një pik tjetër, ku thuhet se: Inxhinieri i Gjeodezisë i prezantuar nga OE "RsmCompany", është ne moshën 73 vjeçar. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues nuk mund te jap ndonjë sqarim.

Eksperti shqyrtues sqaron pretendimet e OE ankues ''Sallahu''-Kaçanik, sqaron se OE ankues me këtë aktivitet te prokurimit ka dorëzuar ofertë për Lot I, II dhe III, ndërsa pas vlerësimit te ofertave eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

Operatori ekonomik menaxherin e projektit, udhëheqësin e punishtes dhe inxhinierin e komunikacionit e ka ofruar me kontratë SallahuShpk, ndërsa noterizimin e kontratës është Sa – Sallahu me nr. Unik 811233668 (biznes tjetër).

Inxhinieri i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik dhe inxhinieri i gjeodezisë ka ofruar kontratë me SallahuShpk, ndërsa noterizimi me NNT Sallahu e cila ne ARBK figuron si kompani e mbyllur nga 2018 (Jo aktive).

Operatori ekonomik ka ofertuar për III pjese ndërsa stafin, pajisjet dhe procesverbalin e ofertave e ka ofruar vetëm për një pjese.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e parë te eliminimit sqaron se ne oferte ne tij OE ankues, ka dorëzuar kontratën e lidhur me mes te OE "Sallahu" Shpk nr. i biznesit 810135237 dhe inxhinierit përkatës, ndërsa kontrata është noterizuar ne emër te një biznesi tjetër – SA Sallahu nr. i biznesit 811233668.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimin e dhënë nga AK-ja, ne letrën standarde ka bere verifikim ne ueb faqen e ARB-se, ne te cilën figuron qe SallahuShpk dhe SA Sallahu janë subjekte te ndryshme përkatësisht me numra te ndryshëm te biznesit.

Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se ka qene një gabim teknik për fakti se OE "SA Sallahu" ekziston i regjistruar ne ARBK.

Lidhur me arsyen e dytë te eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofertë ekziston vërtetimi i lëshuar nga ARBK-ja me datë: 20.07.2018, ne te cilin thuhet OE Sallahu N.N.T e ka ndryshuar tipin si shoqëri me përgjegjësi te kufizuara "Sallahu" Shpk.

Prandaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se me te drejt e ka eliminuar AK-ja, për faktin se ne vërtetimin e bashkangjitur nga vet OE ankues "Sallahu" thuhet se nga 20.07.2018 nuk ekziston N.N.T Sallahu por SallahuShpk, ndërsa vula noteriale mban shifrën LRP.nr.1962/2019. Qe do te thotë se noterizimi është bere për N.N.T Sallahu i cili ne kohen kur është bere nuk ekziston me këtë tip, por si Shpk.

Sa i përket arsyes se tretë te eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit ka kërkuar stafin profesional dhe njëherit ne lidhje me stafin ka dhënë sqarimin si me poshtë:

Vëmendje! Nëse OE aplikon për pjesën 1, pjesën 2 dhe pjesën 3 ne stafin e vete duhet te prezantoj 3 projekt menaxher, 3 udhëheqësa te punishtes, 3 Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik, 3 Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë dhe 3 inxhiniera te komunikacionit.

Ne rastin konkret OE ankues ne ofertën e tij i ka dorëzuar dëshmitë për stafin vetëm për një Lot, ndërsa ne këtë aktivitet te prokurimit ka ofertuar ne tri Lote.

Ne fund sa i përket ofertës se OE ankues "Sallahu", eksperti shqyrtues vlerëson se me te drejt AK-ja, e ka eliminuar për faktin se siç u sqarua edhe me lart, OE ankues ka dorëzuar dëshmi – kontrata pune te lidhura ne mes te punëmarrësit dhe OE "Sallahu" Shpk, ndërsa janë noterizuar për një operator ekonomik tjetër i cili ne bazë te numrit te biznesit është subjekt tjetër dhe i njëjti nuk është ne konzorcium me OE "Sallahu" dhe nuk është pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

Sa i përket pretendimit te OE ankues ne lidhje me ofertën e te rekomanduarit për kontratë për Lot I OE "KagAsphalt", për te cilin pretendon se i njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën ne lidhje me kontratat për Lot I, ku AK-ja, ka kërkuar qe vlera te jet 10,000,000.00€.

Eksperti shqyrtues, pas ka ekzaminuar listën e kontratave te dorëzuar ne ofertën e te rekomanduarit për kontratë, fillimisht sqaron se OE i rekomanduar për kontratë për Lot I ka dorëzuar liste ne kontratave ne vlerë afër: 12,000,000.00€.

Duke u bazuar ne vlerën e lartpërmendur, OE ankues "Sallahu", pretendon se për kontratën e dorëzuar nga i rekomanduari ne vlere prej: 2,809,341.46€, nuk ka dorëzuar pranim përfundimtarë te punëve por, vetëm reference, eksperti shqyrtues, sqaron se qëndron ky pretendim për faktin se i rekomanduari për Lot I nuk ka dorëzuar pranim përfundimtarë sipas kërkesës se dosjes se tenderit por vetëm reference. Lidhur me këtë kontratë eksperti shqyrtues, sqaron se kjo kontratë është lidhur me komisionin evropian. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo është dashur te verifikohet lidhur me pranimin përfundimtar.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues, për kontratën me titull: ndërtimi i rrugës Retij – Mamush, se ne raportin përfundimtarë nuk ka vlere projekti ne fjalë, eksperti shqyrtues sqaron se për kontratën e lartpërmendur përveç raportit përfundimtare te dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar edhe referencën ne te cilën jepet projektit, prandaj është i paqëndrueshëm ky pretendim.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, ne lidhje me kontratën e lidhur me AK-MI, për projektin: Zgjerimi i rrugës nacionale M9 segmenti D Lot II (Lozic-Mleqan), eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim qëndron për faktin se kjo kontratë është vitit 2013, dhe për te njëjtën AK-ja, gjate vlerësimit është dashur ta merr vetëm pjesën e realizuar brenda viteve te kërkuara ne dosje te tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Pretendimi i OE ankues ne lidhje me pajisjet te cilat janë me afat te skaduar te regjistrimit, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk mund te eliminohet një OE për afat te regjistrimit te automjeteve.

Sa i përket pretendimit te OE ankues ne lidhje me pajisjen nr. rendor 6, ku AK-ja, ka kërkuar Autopomp betoni, ndërsa i rekomanduari për kontratë ka ofruar Autobetonier dhe ne librezë nuk ka me shume te dhëna. Prandaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se ne mungesë te dhënave AK-ja, është dashur ti kërkojë sqarime me te detajuara.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Sallahu" ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE te

rekomanduar për kontratë për Lot III, OE "LikaTrade", për te cilin pretendon se nuk ka kontrata dhe referenca sipas kërkesës se AK-se, për Lot III. Eksperti shqyrtues, sqaron se për Lot III, AK-ja, ka kërkuar kontrata dhe referenca për periudhën e shkuar ne vlerë prej: 6,000,000.00€, dhe pas ekzaminimit te ofertës se OE te rekomanduar për kontratë ky operator ekonomik e plotëson kërkesën e AK-se për Lot III.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues, për pajisjen e kërkuar ne piken 2 te listës se pajisjeve, ku OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar me arsyetimin se ka ofruar kamionin me targa 03-341-BI, ndërsa kërkesë ka qene për kamion kiper 10m3. Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, për pajisjen ne fjalë ka kërkuar sqarim nga i rekomanduari për kontratë i cili ka ofruar dëshmi shtese lidhur me pajisjen, prandaj është i paqëndrueshëm ky pretendim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "RSM Company" Prishtinë për Lot III të aprovohet si e bazuar dhe të anulohet njoftimi i AK-së, vendimi për dhënie të kontratës për Lot III, ndërsa ankesa e OE ankues "Sallahu" te aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të anulohet vendimi për dhënie të kontratës për Lot I dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Infrastrukturës, me datë: 28.06.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik–''Sallahu'' SHPK -Kaçanik,me datë: 02.07.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik–OE "RSM COMPANY" SH.P.K-Prishtinë , me datë: 28.06.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 04.07.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të OSHP-së, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se OE "RSM COMPANY" Prishtinë , me dt.03.07.2019, ka bëre kërkesë në OSHP duke kërkuar që ti aprovohet kërkesa e tij për tërhiqje nga ankesa e tij me numër 297/19, e datës:10.06.2019, duke u arsyetuar qe për shkak te interesit publik në mënyrë që mos të ketë pengesa lidhur me zhvillimin e këtij projekti shumë te rëndësishëm dhe për shkak te procedurave te stërzgjatura neve si kompani nuk na konvenon qe te vazhdojmë me procedurat e shqyrtimit te mëtutjeshme te ankesës me nr. 297/19, andaj edhe kërkojmë te tërhiqemi nga kjo ankesë.

Paneli shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar kërkesën e OE "RSM COMPAY" Prishtinë të datës 03.07.2019, për tërheqje nga ankesa e dt.10.06.2019, dhe konstaton se e njëjta kërkesë aprovohet sepse ankuesi jep arsye bazike për aprovim dhe se shqyrtimi i pretendimeve ankimore te këtij operatori ekonomik përfundon në ketë fazë.

Paneli shqyrtues konstaton se OE "SALLAHU" SHPK - Kaçanik, ka dështuar të provojë se është palë me interes në aktivitetin e prokurimit në fjalë sepse i njëjti që nga data: 03.07.2019 deri më 03.01.2020, është në Listën e Zezë, andaj në pajtim me nenin 99 të LPP- së ky operator ekonomik nuk mund te merr pjesë në aktivitete të prokurimit dhe të shpërblehet me kontrata derisa është në listën e zezë sipas vendimit të OSHP-së PSH. nr. 548/19 , të dt. 03.07.2019.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 26 pika 1 të LPP- së në të cilin thuhet: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, konstaton se në rastin konkret operatori ekonomik "Sallahu" SHPK- Kaçanik , është operator ekonomik i cili nuk mund të dëshmoj interes material për aktivitetin e prokurimit për te cilin ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 318/19, te dt.17.06.2019, për faktin se ky operator ekonomik është konstatuar se ka paraqitur dokumente të rreme –falsifikuara në AK MI dhe për të njëjtin operator ekonomik OSHP-ja, ka marr vendim në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së , duke e futur në listën e zezë te njëjtin OE për një periudhe prej gjashtë muajve (6 muajve) , ku këtij operatori ekonomik i ndalohet pjesëmarrja në aktivitete te prokurimit nga data: 03.07.2019 deri me 03.01.2020.

Paneli shqyrtues sqaron se gjate kësaj periudhe kohore derisa OE " SALLAHU" SHPK- Kaçanik, është në listën e zezë, duke u bazuar në nenin 99 të LPP-së të njëjtit operator ekonomik i ndalohet pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit, sepse neni 99.2 i LPP-së specifikon: Në bazë të një kërkese me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga

operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se operatori ekonomik ankues "SALLAHU" SHPK Kaçanik, në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi, ashtu siç u sqarua si më lart.

Paneli shqyrtues për aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe rekomandimin për dhinë të kontratës, **konstaton se vet autoriteti kontraktues MI ka përgjegjësi ligjore lidhur me procedurat e udhëhequra**, për faktin se paneli shqyrtues nuk ka vendosur lidhur me shkeljet e supozuara nga OE "SALLAHU" SHPK, Kaçanik sepse ankesa e OE " SALLAHU" SHPK Kaçanik, është hedhur si pa lejuar konform vendimin 548/19 te datës 03.07.2019, pretendimet ankimore nuk janë shqyrtuar. Po ashtu as pretendimet e OE "RSM COMPANY " SHPK Prishtinë nuk janë shqyrtuar nga ana e panelit shqyrtues sepse i njëjti OE ka kërkuar që te tërhiqet nga shqyrtimi i mëtejme i ankesës së tij me nr. 297/19 të dt. 10.06.2019.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Ministria e Infrastrukturës

1x1 OE- OE "RSM COMPANY" SH.P.K-Prishtinë

1x1 OE - ''SALLAHU'' SHPK - Kaçanik,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.